

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje kondicionerë për godinat arsimore dhe institucionet”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 39717200-3, 45331220-4

Vlera e fondit limit: 3 328 128 (tremilion e treqindnjëzetetë mijë e njëqindnjëzetetë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar. Ky kriter synon të sigurojë që çdo operator ekonomik të konfirmojë paraprakisht, nën përgjegjësi ligjore, përmbushjen e kushteve dhe kërkesave të përgjithshme të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik. Përmes vetëdeklarimit mundësohet një zhvillim më efikas i procedurës së vlerësimit të ofertave, duke shmangur ngarkesën administrative të paraqitjes së menjëhershme të dokumentacionit të plotë nga të gjithë ofertuesit, ndërkohë që autoriteti kontraktor ruan të drejtën për të kërkuar dhe verifikuar dokumentacionin provues përkatës në fazat e mëvonshme të procedurës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 OE duhet te paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”*.

Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”*.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në

fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “*Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën*” nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se “*Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit.

Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4, gërma (b) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/marrëveshje nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Në rast se autorizimi paraqitet nga distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të dokumentojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar, nëpërmjet dokumentacionit përkatës provues. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm dhe të përmbajë të dhëna të plota identifikuese të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, si: adresë, numër telefoni dhe e-mail të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi të dokumentacionit të paraqitur.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*”.

Autoriteti kontraktor, duke qënë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallit që kërkohet në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtij malli, nisur edhe nga rëndësia dhe specifikat që ka malli objekt prokurimi. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale për mall sa më cilësor, pra

garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohet të blihet e që është prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për aftësitë teknike.

Duke qenë se kondicionerët janë pajisje elektro-mekanike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në komoditetin, shëndetin dhe kushte e punës/mësimin në ambientet publike, është thelbësore që ato të jenë produkte origjinale të prodhuesve të njohur dhe të furnizuara përmes kanaleve zyrtare të shpërndarjes. Ky kriter siguron që pajisjet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, standardet e deklaruara të efikasitetit energjetik dhe normat e sigurisë në fuqi.

Në rastet kur autorizimi paraqitet nga distributori zyrtar, kërkohet detyrimisht dokumentimi i marrëdhënies ndërmjet distributorit dhe prodhuesit, me qëllim verifikimin e zinxhirit të furnizimit dhe sigurimin se distributori është i autorizuar realisht për tregtimin dhe furnizimin e produkteve përkatëse. Kjo shmang rrezikun e furnizimit me produkte jo origjinale, të paçertifikuara ose jashtë rrjetit zyrtar të prodhuesit.

Kërkesa që autorizimi të jetë i vlefshëm dhe të përmbajë të dhëna të plota identifikuese të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, si adresë, numër telefoni dhe e-mail, është vendosur për të mundësuar verifikim të drejtpërdrejtë nga Autoriteti Kontraktor. Këto të dhëna rrisin transparencën dhe i japin mundësi autoritetit të konfirmojë autenticitetin e dokumentacionit të paraqitur në çdo fazë të procedurës.

Në kontekstin e këtij prokurimi, ky kriter është veçanërisht i rëndësishëm pasi garanton origjinalitetin e kondicionerëve të ofruar, siguron përputhshmëri me standardet e kërkuara teknike (CE, ErP, etj.), ul rrezikun e defekteve teknike dhe mosfunksionimit gjatë përdorimit, siguron disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit dhe shërbimit të servisit gjatë periudhës së garancisë dhe rrit besueshmërinë e zinxhirit të furnizimit për pajisje që do të përdoren në ambiente publike me ndjeshmëri të lartë. Në tërësi, ky kriter kontribuon në realizimin me sukses të kontratës, duke garantuar cilësi, siguri dhe qëndrueshmëri të pajisjeve të furnizuara për godinat arsimore dhe institucionet publike.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të vlefshme të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të cilat kanë lidhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 (ose ekuivalente/e përditësuar) për sistemin e menaxhimit të cilësisë, me fushë veprimtarie që lidhet me objektin e prokurimit;

- ISO 50001:2018 (ose ekuivalente/e përditësuar) për sistemin e menaxhimit të energjisë, me fushë veprimtarie që lidhet me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të*

njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Kërkesa që operatori ekonomik ofertues të jetë i pajisur me certifikata ISO 9001:2015 dhe ISO 50001:2018, të lëshuara nga organizma të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga organizma ndërkombëtarë të njohur, vendoset me qëllim garantimin e cilësisë së mallrave dhe shërbimeve që lidhen me furnizimin, instalimin dhe vënien në funksion të kondicionerëve në godinat arsimore dhe institucionet publike.

Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin pajisje elektro-mekanike që ndikojnë drejtpërdrejt në komfortin termik, shëndetin dhe kushte e punës/mësimin në ambientet institucionale, është thelbësore që procesi i furnizimit të realizohet nga operatorë ekonomikë që zbatojnë sisteme të mirëstrukturuara të menaxhimit të cilësisë dhe energjisë.

Certifikimi ISO 9001:2015 garanton që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem efektiv të menaxhimit të cilësisë, i cili siguron kontroll të standardizuar të proceseve të furnizimit dhe instalimit, reduktim të gabimeve teknike dhe jo-konformiteteve, gjurmueshmëri dhe përgjegjshmëri në çdo fazë të realizimit të kontratës dhe përmbushje të kërkesave teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Ndërkohë, certifikimi ISO 50001:2018 garanton që operatori ekonomik aplikon një sistem të menaxhimit të energjisë, i cili është veçanërisht i rëndësishëm për këtë objekt prokurimi, pasi kondicionerët janë pajisje me konsum të konsiderueshëm energjetik. Ky standard kontribuon në përdorimin efikas të energjisë gjatë përzgjedhjes dhe instalimit të pajisjeve, promovimin e pajisjeve me efikasitet të lartë energjetik, reduktimin e kostove operacionale për institucionet publike dhe minimizimin e ndikimit në mjedis përmes konsumit të optimizuar të energjisë.

Kërkesa që certifikatat të jenë të lëshuara nga organizma të akredituar nga DPA ose nga organizma ndërkombëtarë të njohur siguron vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre, duke garantuar se standardet e deklaruara janë të verifikuara dhe të pranuar ndërkombëtarisht.

Ky kriter është vendosur për të siguruar që operatori ekonomik ka kapacitete të provuara organizative dhe teknike, zbaton praktika profesionale të menaxhimit të cilësisë dhe energjisë, aranton furnizim dhe instalim të pajisjeve në përputhje me standardet më të mira dhe kontribuon në realizimin me sukses, efikasitet dhe qëndrueshmëri të kontratës publike për godinat arsimore dhe institucionet.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë, broshura ose dokumentacion teknik për mallrat e ofertuar, ku të identifikohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili artikull, modeli përkatës dhe specifikimet teknike të deklaruara sipas kërkesave të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST).

Dokumentacioni teknik i paraqitur duhet të përmbajë karakteristikat teknike për secilin artikull objekt prokurimi, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë përputhshmërinë e mallrave të ofertuar me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Specifikimet teknike të modeleve të ofertuara do të krahasohen me të dhënat e paraqitura në katalogë/broshura dhe me specifikimet teknike të DST-së, për të vlerësuar përputhshmërinë e tyre.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik.

Kërkesa që operatori ekonomik ofertues të paraqesë katalogë, broshura ose dokumentacion teknik për mallrat e ofertuar vendoset me qëllim garantimin e verifikueshmërisë teknike, transparencës së ofertës dhe përputhshmërisë së plotë të pajisjeve me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST).

Duke qenë se objekti i prokurimit konsiston në furnizimin dhe instalimin e kondicionerëve për godinat arsimore dhe institucionet publike, pajisje të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në komfortin termik, cilësinë e ajrit të brendshëm dhe eficiencën energjetike të ndërtesave publike, është e domosdoshme që çdo produkt i ofertuar të identifikohet në mënyrë të saktë dhe të verifikueshme përpara vlerësimit teknik të ofertës.

Paraqitja e katalogëve ose broshurave zyrtare të prodhuesit shërben si dokumentacion teknik autentik, i cili përmban parametrat realë të produktit dhe jo deklaratime të përgjithshme të operatorit ekonomik. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për pajisjet HVAC (Heating, Ventilation and Air Conditioning), ku performanca varet nga një sërë parametrash teknikë të ndërlidhur, si kapaciteti nominal dhe sezonal i ftohjes/ngrohjes (kW, BTU/h), koeficientët e eficiencës energjetike (SEER, SCOP), lloji i gazit ftohës dhe ndikimi mjedisor (p.sh. R32 me GWP të ulët), niveli i zhurmës në funksionim (dB(A)), debitimi i ajrit (m³/h), diapazoni i temperaturave të operimit dhe dimensionet fizike dhe kërkesat për instalim.

Ky dokumentacion i mundëson Autoritetit Kontraktor të kryejë një verifikim teknik të detajuar, duke krahasuar çdo parametër të ofertuar me kërkesat minimale të përcaktuara në DST. Krahasimi kryhet në mënyrë objektive dhe të matshme, duke siguruar që pajisjet e propozuara përmbushin standardet e kërkuara të performancës, sigurisë dhe eficiencës energjetike.

Gjithashtu, katalogët zyrtarë përbëjnë bazë për identifikimin e saktë të modelit dhe versionit të pajisjes, duke shmangur rrezikun e ofertimit të produkteve të ngjashme, por me karakteristika teknike inferiore ose jo të njëjta me ato të deklaruara në ofertë.

Ky kriter siguron gjithashtu gjurmueshmërinë teknike të produktit (traceability) sipas prodhuesit, verifikimin e përputhshmërisë me standardet europiane (EN 14511, EN 14825, EN 378), kontrollin e parametrave të eficiencës energjetike në përputhje me ErP Directive dhe minimizimin e riskut të mospërputhjes teknike gjatë fazës së zbatimit të kontratës.

Në kontekstin e këtij prokurimi, ku pajisjet do të instalohen në ambiente me përdorim të lartë publik (shkolla, zyra dhe institucione), ky verifikim është thelbësor për të garantuar funksionim të qëndrueshëm, konsum të ulët energjie, nivel të pranueshëm zhurme dhe jetëgjatësi operative të sistemit HVAC.

Ky kriter rrit nivelin e kontrollit teknik të ofertave, siguron krahasueshmëri reale ndërmjet ofertuesve dhe garanton që kontrata të realizohet me pajisje origjinale, të certifikuar dhe plotësisht të përputhshme me kërkesat funksionale dhe teknike të Autoritetit Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, nëpërmjet së cilës garanton se mallrat objekt prokurimi do të kenë afatin e garancisë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike përkatëse.

Argumentim: Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe pikën 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë

kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë me të cilën garanton se mallrat objekt prokurimi do të kenë afatin e garancisë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara, vendoset me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së funksionimit të pajisjeve dhe mbrojtjen e interesit publik gjatë gjithë periudhës së përdorimit të tyre në godinat arsimore dhe institucionet publike.

Duke qenë se kondicionerët janë pajisje elektro-mekanike që punojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe janë të ekspozuara ndaj ngarkesave të ndryshme operative dhe kushteve ambientale të ndryshueshme, garancia përbën një element thelbësor të sigurisë teknike dhe ekonomike të investimit publik. Përmes këtij kriteri sigurohet që operatori ekonomik merr përgjegjësi të plotë për funksionimin normal të pajisjeve për një periudhë të caktuar kohe, duke përfshirë riparimin, zëvendësimin e pjesëve defekte dhe mbështetjen teknike pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor, në përputhje me kushtet e përcaktuara në specifikimet teknike.

Ky angazhim i deklaruar është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e përdorimit të pajisjeve në institucione arsimore dhe publike, ku kërkohet funksionim i pandërprerë, komoditet termik i qëndrueshëm dhe minimizim i ndërhyrjeve teknike që mund të ndikojnë në procesin mësimor dhe administrativ. Garancia shërben gjithashtu si tregues indirekt i cilësisë së produktit dhe besueshmërisë së prodhuesit, duke reflektuar qëndrueshmërinë dhe standardin teknik të pajisjeve të ofruara.

Nga ana tjetër, ky kriter krijon një mekanizëm të qartë përgjegjshmërie për operatorin ekonomik, duke siguruar që ai nuk kufizohet vetëm në furnizimin e pajisjeve, por angazhohet edhe për performancën e tyre gjatë periudhës së përdorimit. Kjo redukton ndjeshëm rrezikun e kostove të paplanifikuara për riparime ose zëvendësime të parakohshme dhe garanton një menaxhim më efikas të fondeve publike.

Në tërësi, ky kriter siguron që pajisjet e furnizuara të jenë të mbështetura nga një garanci reale dhe e zbatueshme, e cila garanton cilësinë, besueshmërinë dhe funksionimin e qëndrueshëm të sistemit të kondicionimit në godinat arsimore dhe institucionet publike, duke kontribuar drejtpërdrejt në realizimin me sukses dhe qëndrueshmëri të kontratës publike.

2.3.6 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë, nëpërmjet së cilës merr përsipër mbulimin e shërbimit të servisit dhe mirëmbajtjes për pajisjet e ofertuara gjatë gjithë periudhës së garancisë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike.

Argumentim: Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti

kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe pikën 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kërkesa që operatori ekonomik ofertues të paraqesë një deklaratë përmes së cilës merr përsipër mbulimin e shërbimit të servisit dhe mirëmbajtjes për pajisjet e ofruara gjatë gjithë periudhës së garancisë, vendoset me qëllim garantimin e funksionimit të pandërprerë dhe të qëndrueshëm të sistemit të kondicionimit në godinat arsimore dhe institucionet publike.

Duke qenë se kondicionerët janë pajisje elektro-mekanike që funksionojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe janë të ekspozuara ndaj konsumit natyror, kushteve të ndryshme të përdorimit dhe ngarkesave operative sezonale, sigurimi i shërbimit të servisit dhe mirëmbajtjes gjatë periudhës së garancisë është një element thelbësor për ruajtjen e performancës teknike të tyre dhe parandalimin e defekteve që mund të ndikojnë në funksionimin normal të ambienteve publike.

Ky angazhim garanton që çdo defekt teknik, mosfunksionim apo nevojë për ndërhyrje në pajisje do të trajtohet në kohë dhe pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor, duke përfshirë diagnostikimin, riparimin, zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara dhe çdo ndërhyrje tjetër të nevojshme për rikthimin në gjendje pune të pajisjeve. Në këtë mënyrë sigurohet vazhdimësia e shërbimit dhe shmangia e ndërprerjeve që mund të ndikojnë në procesin mësimor dhe administrativ.

Gjithashtu, ky kriter shërben si garanci për kapacitetin teknik dhe organizativ të operatorit ekonomik, duke treguar se ai disponon strukturën dhe mundësitë e nevojshme për të ofruar mbështetje pas shitjes në përputhje me standardet e kërkuara. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për pajisjet HVAC, të cilat kërkojnë mirëmbajtje periodike dhe ndërhyrje profesionale për të ruajtur eficiencën energjetike, performancën optimale dhe jetëgjatësinë e sistemit.

Ky kriter siguron që furnizimi i kondicionerëve të mos kufizohet vetëm në dorëzimin e pajisjeve, por të shoqërohet me një shërbim të plotë teknik gjatë periudhës së garancisë, duke garantuar cilësi, besueshmëri dhe funksionim të qëndrueshëm të tyre në godinat arsimore dhe institucionet publike.

Argumentimi teknik i specifikimeve

1. Konditioner Inverter mural 24000 BTU/h

Specifikimet e kërkuara për këtë pajisje bazohen në nevojën për të siguruar kapacitet të lartë ftohjeje dhe ngrohjeje për ambiente me sipërfaqe të konsiderueshme në godinat arsimore dhe institucionale. Kapaciteti termik 7.1 kW (ftohje) dhe 8.2 kW (ngrohje) garanton stabilitet termik në kushte të ndryshueshme klimatike.

Rrjedha e ajrit (600–1040 m³/h) siguron shpërndarje të njëtrajtshme të temperaturës në ambient, duke shmangur zonat me diferencë termike. Niveli i zhurmës 30–40 dB(A) është i përshtatshëm për ambiente mësimore dhe administrative, duke garantuar komoditet akustik.

Klasi i energjisë A+++ / A++ dhe përdorimi i gazit R32 justifikohen nga nevoja për efikasitet të lartë energjetik dhe reduktim të ndikimit mjedisor. Përfshirja e WiFi mundëson menaxhim inteligjent të temperaturës dhe optimizim të konsumit.

Përputhshmëria me standardet EN 14511, EN 378, EN 14825 garanton performancë të verifikuar laboratorikisht, siguri në sistemet ftohëse dhe efikasitet sezonal energjetik. Kërkesat CE, ErP,

RoHS dhe WEEE sigurojnë përputhshmëri me legjislacionin e BE për sigurinë, mjedisin dhe produktet elektrike.

2. Kondicioner Inverter mural 18000 BTU/h

Ky model synon mbulimin e ambienteve me përmasa mesatare. Kapaciteti 5.0 kW (ftohje) dhe 6.3 kW (ngrohje) është i përshtatshëm për klasa, zyra dhe ambiente administrative.

Parametrat e qarkullimit të ajrit (500–995 m³/h) sigurojnë shpërndarje efikase të ajrit të kondicionuar. Niveli i zhurmës i kufizuar në 30–40 dB(A) ruan kushte të përshtatshme pune dhe mësimi.

Klasi energjetik A+++/A++ dhe përdorimi i R32 kontribuojnë në kursim energjie dhe reduktim të emetimeve të gazeve serrë. Funkzioni WiFi rrit fleksibilitetin në menaxhimin e pajisjes.

Standardet EN 14511, EN 378 dhe EN 14825 sigurojnë vlerësim të saktë të performancës dhe sigurisë, ndërsa CE, ErP, RoHS dhe WEEE garantojnë përputhshmëri ligjore dhe mjedisore.

3. Tub bakri i termoizoluar (1/4" + 1/2")

Tubacionet e bakrit sipas EN 12735-1:2020 sigurojnë cilësi të lartë për sistemet HVAC, duke garantuar rezistencë ndaj presionit, korrozionit dhe jetëgjatësi të lartë operative.

Materiali Cu-DHP (≥99.90% Cu) siguron përçueshmëri optimale dhe qëndrueshmëri kimike. Izolimi PE-X foam me përçueshmëri 0.036 W/m·K dhe klasë zjarri Euroclass B-s2, d0 redukton humbjet termike dhe rrit sigurinë ndaj zjarrit.

Përdorimi i tubave të parapërgatitur (pre-insulated) minimizon humbjet gjatë instalimit dhe rrit cilësinë e sistemit. Kërkesa për markim, certifikim CE, DoC dhe ISO 9001 siguron gjurmueshmëri dhe kontroll cilësie.

Garantimi afatgjatë dhe instalimi sipas praktikave HVAC sigurojnë funksionim të qëndrueshëm dhe shmangie të defekteve teknike si urat termike ose deformimet mekanike.

4. Tub bakri i termoizoluar 1/4" (6.35 mm)

Ky tub përdoret për linjat e ftohjes me diametër të vogël në sistemet split. Specifikimet sipas EN 12735 sigurojnë standardizim të plotë dhe përputhshmëri me sistemet moderne HVAC.

Izolimi PE-X foam 9 mm minimizon kondensimin dhe humbjet termike, ndërsa klasa Euroclass B garanton siguri ndaj zjarrit në ambiente të brendshme.

5. Tub bakri i termoizoluar 5/8" (15.9 mm)

Ky tub shërben për linjat kryesore të qarkullimit të gazit ftohës në sisteme me kapacitet më të lartë. Trashësia 1 mm siguron rezistencë ndaj presionit të lartë operativ.

Izolimi termik dhe standardet EN 12735 sigurojnë efikasitet dhe jetëgjatësi në përdorim intensiv.

6. Veshje termoizoluese elastomerike (9 mm)

Materiali elastomerik me qeliza të mbyllura siguron izolim të lartë termik (0.033 W/m·K) dhe rezistencë ndaj kondensimit.

Klasifikimi Euroclass B-s2, d0 garanton siguri ndaj zjarrit në ambiente të mbyllura si shkolla dhe institucione publike. Ky material është i domosdoshëm për reduktimin e humbjeve energjetike dhe mbrojtjen e tubacioneve.

7. Struktura mbajtëse galvanizuar

Elementët mbajtës (fasheta, upa, dado, rondele) prej çeliku të galvanizuar sigurojnë rezistencë ndaj korrozionit dhe stabilitet mekanik të njëjësive të jashtme dhe tubacioneve.

Galvanizimi garanton jetëgjatësi në kushte atmosferike të ekspozuara dhe ul nevojën për mirëmbajtje.

8. Rakorderi për kondensë PP-R

Sistemi PP-R SDR11 PN6 është i përshtatshëm për shkarkimin e ujërave të kondensit në sistemet HVAC, duke siguruar rezistencë kimike dhe mekanike.

Standardet EN ISO 15874 dhe EN ISO 1167 garantojnë jetëgjatësi dhe rezistencë ndaj presionit dhe temperaturës. CE Marking dhe RoHS sigurojnë përputhshmëri ligjore dhe mjedisore.

9. Kabëll elektrik 4x1.5 mm² për multisplit

Kablli me përçues bakri dhe izolim PVC të dyfishtë siguron transmetim të sigurt të energjisë dhe sinjalit ndërmjet njësive të brendshme dhe të jashtme.

Seksioni 4x1.5 mm² është i përshtatshëm për ngarkesat elektrike të sistemeve multisplit, duke garantuar stabilitet dhe shmangie të humbjeve të tensionit.

Izolimi PVC siguron rezistencë mekanike dhe mbrojtje ndaj lagështirës, duke e bërë të përshtatshëm për instalime të brendshme dhe të jashtme.

Kërkesa që montimi, instalimi dhe vënia në funksion e pajisjeve të realizohet nga Operatori Ekonomik fitues është teknikisht e domosdoshme për të garantuar funksionimin korrekt, sigurinë dhe jetëgjatësinë e pajisjeve të kondicionimit. Pajisje të tilla kërkojnë instalim profesional sipas standardeve teknike të prodhuesit dhe kushteve konkrete të objekteve ku do të vendosen. Kryerja e instalimit nga vetë operatori siguron përgjegjësi të plotë për cilësinë e punimeve, shmang mosfunksionimet që mund të vijnë nga montimi i gabuar dhe garanton kompatibilitetin e sistemit elektrik, tubacioneve dhe elementeve mbështetëse me parametrat teknikë të pajisjeve.

Vënia në funksion e kondicionerëve në godinat arsimore dhe institucionet përkatëse kërkon testim teknik, kontroll të parametrave të punës, verifikim të qarkullimit të gazit ftohës, kontroll të lidhjeve elektrike dhe sigurimin e performancës optimale energjetike. Kjo është e rëndësishme për të garantuar kushte të përshtatshme ambientale në institucionet publike, efikasitet energjetik dhe reduktim të kostove operative.

Kërkesa që operatori ekonomik të marrë përsipër shpimet e mureve, izolimet dhe mbylljen e tyre është e arsyetuar teknikisht pasi instalimi i njësive të brendshme dhe të jashtme kërkon kalimin e tubacioneve, kabllave elektrike dhe sistemit të drenazhimit. Kryerja e këtyre punimeve nga i njëjti operator garanton integritetin teknik të instalimit, ruajtjen e izolimit termik dhe estetik të objektit, si dhe shmang dëmtimet strukturore apo depërtimin e lagështirës në fasada dhe mure.

Periudha minimale e garancisë prej jo më pak se një viti është një kërkesë standarde teknike dhe funksionale që siguron mbrojtjen e Autoritetit Kontraktor ndaj defekteve të prodhimit ose problemeve të fshehta të pajisjeve. Gjatë kësaj periudhe, operatori ekonomik duhet të ofrojë pa pagesë riparimin, mirëmbajtjen dhe servisin teknik, duke garantuar vazhdimësinë e funksionimit të pajisjeve dhe ndërhyrje të shpejta në rast avarie. Kjo kërkesë kontribuon në sigurimin e cilësisë së mallrave të furnizuara, minimizimin e kostove shtesë për institucionin dhe garantimin e performancës sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

NJËSIA E PROKURIMIT